

VENDIM
Nr. 347, datë 5.11.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR PËRZGJEDHJEN E PROKURORËVE NË SKEMËN E DELEGIMIT”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës; në nenin 45, pika 8, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, 189, pika 1, germa “c” dhe 190, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore, “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e prokurorëve në skemën e delegimit”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot, më 5.11.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

RREGULLORE
**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E PROKURORËVE NË
SKEMËN E DELEGIMIT**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet për të aplikuar, kriteret e përzgjedhjes dhe procedurën e vlerësimit të prokurorëve, që marrin pjesë në Skemën e Delegimit.

Neni 2
Parimet mbi të cilat ngrihet skema e delegimit

Skema e delegimit, mbështetet dhe funksionon bazuar në:

- a) parimin e ligjshmërisë;
- b) respektimin e pavarësisë së prokurorit;
- c) aplikimin e lirë dhe të vullnetshëm;
- ç) transparencën;
- d) parimin e eficiencës.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Këshilli”, është Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

b) “KZHK”, është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës;

c) “Ligji nr. 96/2016”, është ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

ç) “Skema e Delegimit”, është një mekanizëm institucional, që mundëson caktimin e prokurorëve, për çështje apo periudha të caktuara, në prokurori të ndryshme, me qëllim për të përmbushur nevojat e përkohshme, si edhe për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit dhe për të adresuar mungesën e personelit brenda këtyre prokurorive.

KREU II KRIJIMI DHE STRUKTURA E SKEMËS SË DELEGIMIT

Neni 4

Procedura për krijimin e Skemës së Delegimit

1. Këshilli, çdo vit, por jo më vonë se data 10 nëntor, përcakton numrin e prokurorëve, për çdo nivel dhe funksion, të cilët do të shërbejnë në Skemën e Delegimit.

2. Për të nxjerrë vendimin e parashikuar në pikën 1, të kësaj dispozite, KZHK-ja, deri në datën 30 shtator, realizon një vlerësim të pozicioneve të lira, duke përllogaritur daljet në pension, përfundimin e statusit të magjistratit, për çfarëdo shkaku, krijimit të pozicioneve të lira në mënyrë të përkohshme ose të krijimit të pengesave ligjore të përkohshme apo të përhershme për prokurorë të caktuar, për çfarëdo arsye.

3. Këshilli, deri më 10 nëntor, identifikon listën e prokurorive që mund të përfitojnë nga aplikimet e prokurorëve nga Skema e Delegimit. Për të zgjedhur se në cilën prokurori duhet të caktohen prokurorët, sipas kësaj skeme, Këshilli duhet të vlerësojë kriteret e mëposhtme:

a) shkallën më të lartë të pozicioneve të lira të punës, bazuar në hartën e pozicioneve të lira të prokurorive, të hartuar çdo vit nga Këshilli, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e pozicioneve të lira të punës, sasinë dhe natyrën e çështjeve të trajtuara, sipas informacionit dhe të dhënave statistikore të ofruara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme;

b) shkallën më të lartë të rrjedhës së punës dhe të çështjeve të mbartura të prokurorisë. Në këtë drejtim, Këshilli duhet të marrë në konsideratë edhe kompleksitetin e veçantë të çështjeve të mbartura, për sa i përket çështjes konkrete, numrit të palëve të përfshira, pozicioneve të lira të punës të krijuara papritur si rezultat i ngjarjeve të paparashikueshme, ku përfshihen, por pa u kufizuar në to, raste të tilla, si: vdekja, shtatzënia, sëmundja, mosushtrimi i funksioneve për shkak të pezullimit si rezultat i fillimit të ndjekjes penale, procedimit disiplinor apo pezullimit nga funksioni për çfarëdo arsye.

4. Përveç kriteve të mësipërme, Këshilli, nuk pranon në Skemën e Delegimit atë prokuror që aplikon nga një prokurori, e cila, për arsye të ndryshme, ka më shumë se 25% të vendeve vakante, në momentin e aplikimit.

Neni 5

Zbatueshmëria

1. Skema e Delegimit zbatohet për të mbuluar:

a) çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat;

b) çdo pozicion në Prokurori të Posaçme, nëse magjistrati përmbush kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji;

c) hetimin e një ose disa çështjeve të veçanta në prokurori, për të cilën magjistrati përmbush kërkesat. Në rastet kur caktohet për hetimin e një ose disa çështjeve të veçanta në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të përmbushë kriteret, si dhe të japë pëlqimin, sipas nenit 47, të

këtij ligji. Delegimi për një çështje të veçantë kryhet kur prokurorët e kësaj prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për hetimin e një apo disa çështjeve.

Neni 6

Pranueshmëria, kohëzgjatja dhe përjashtimi

1. Prokurorët mund të përfshihen në Skemën e Delegimit, nëse plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) të kenë të paktën 1(një) vit përvojë profesionale si prokuror;
- b) të kenë dhënë pëlqimin paraprak, me shkrim, në mënyrë të vullnetshme, për t'u caktuar në çdo prokurori të vendit, sipas formularit bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

2. Një prokuror qëndron në Skemën e Delegimit, për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjet. Në çdo rast, prokurori, kur aplikon, merr përsipër që të shërbejë në Skemën e Delegimit për të gjithë këtë periudhë, përveç, nëse ka arsye të justifikuara për tërheqjen e tij nga skema, sipas parashikimeve të nenit 19, të rregullores.

KREU III

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Neni 7

Thirrja për aplikime

1. Këshilli, pasi ka identifikuar prokuroritë në nevojë dhe konstaton mungesa prokurorësh në Skemën e Delegimit, hap thirrjen për aplikim për prokurorët që duan të bëhen pjesë e kësaj skeme, thirrje, e cila duhet të bëhet deri në 31 tetor të atij viti që merret ky vendim.

2. Në thirrjen për aplikim, Këshilli, specifikon: kriteret e pranueshmërisë, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet e procedurës.

3. Aplikimi bëhet nëpërmjet mjeteve elektronike, sipas udhëzimeve që nxjerr Këshilli, në thirrjen për aplikim.

Neni 8

Aplikimi i kandidatëve

Kandidatët duhet të paraqesin aplikimin e tyre pas shpalljes së thirrjes, duke plotësuar formularët e përcaktuar dhe duke bashkëngjitur çdo dokumentacion të kërkuar.

Neni 9

Kriteret për të caktuar një prokuror nga Skema e Delegimit, në një prokurori

1. Prokurorët, pjesë e Skemës së Delegimit, mund të caktohet në një prokurori tjetër, nëse:

- a) përmbushin kërkesat ligjore;
- b) japin pëlqimin dhe disponueshmërinë për të shërbyer në çdo prokurori të vendit;
- c) nuk kanë masa disiplinore në fuqi.

Neni 10

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, mbasi vlerëson aplikimet e paraqitura, brenda 2 (dy) javësh, harton një relacion që ia paraqet Këshillit, ku pasqyrohen: aplikimet e paraqitura, cilat prej tyre pranohen apo jo, së bashku me arsyet përkatëse, si edhe cilësimin për secilin prokuror, se në cilën lloj prokurorie mund të caktohet ai/ajo.

2. Këshilli e shqyrton relacionin e përgatitur nga KZHK-ja, në mbledhjen e tij më të afërt, duke vendosur miratimin e tij, miratimin me ndryshime, apo të kërkojë që të përgatitet një tjetër relacion, duke specifikuar dhe arsyet përkatëse. Në rastin e fundit, KZHK-ja duhet të hartojë një relacion të ri, brenda 10 (dhjetë) ditësh.

KREU IV KUSHTET SPECIFIKE PËR CAKTIMIN

Neni 11

Caktimi në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

Një prokuror i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Skemë Delegimi mund të caktohet për të shërbyer në çdo zyrë prokurorie, të këtij niveli.

Neni 12

Caktimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

1. Një prokuror i shkallës së parë mund të caktohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas Skemës së Delegimit, me kusht që ai të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore të zbatueshme për prokurorët që shërbejnë në këtë nivel, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016.

2. Një caktim i tillë konsiderohet i përkohshëm dhe, në asnjë rast, nuk mundet të konsiderohet si ngritje në detyrë apo transferim i përhershëm.

Neni 13

Caktimi në Prokurorinë e Posaçme

1. Caktimi në Prokurorinë e Posaçme lejohet vetëm, nëse prokurori:

a) përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 47, të ligjit nr. 96/2016, për këtë strukturë;
b) prokurori dhe familjarët e tij kanë dhënë pëlqimin, sipas kërkesave të nenit 148/“dh”, pika 5 të Kushtetutës dhe nenit 6, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin”.

2. Një caktim i tillë konsiderohet i përkohshëm dhe, në asnjë rast, nuk mundet të konsiderohet si ngritje në detyrë apo transferim i përhershëm.

Neni 14

Caktimi për raste specifike

1. Në rast se të gjithë prokurorët brenda një prokurorie të caktuar janë të ndaluar ligjërisht të hetojnë një çështje, Këshilli mund të caktojë nga Skema e Delegimit, për atë çështje.

KREU V KËRKESAT NGA PROKURORITË

Neni 15

Paraqitja e kërkesave

1. Drejtuesi i çdo prokurorie mund të kërkojë caktimin e një prokurori nga Skema e Delegimit.

2. Një kërkesë e tillë, e hartuar sipas formularit, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, duhet të përfshijë:

a) identifikimin e rasteve ose nevojave që justifikojnë caktimin;

- b) arsye specifike, bazuar në domosdoshmërinë funksionale ose hetimore;
 - c) profilin profesional që duhet të ketë prokurori, për të cilën bëhet kërkesë për t'u caktuar;
 - d) arsyet objektive që pengojnë trajtimin e çështjes nga prokurorët e asaj prokurorie.
3. Në çdo rast, drejtuesi i prokurorisë që paraqet kërkesën, nuk mundet që të tregojë nominalisht prokurorët që kërkon që të caktohen, në prokurorinë që ai drejton.

Neni 16

Vlerësimi dhe vendimi

1. KZHK-ja vlerëson kërkesën e paraqitur brenda 7 (shtatë) ditëve punë, nga momenti i paraqitjes së saj.
2. Në përzgjedhjen e prokurorit që do të caktohet, KZHK-ja merr në konsideratë:
 - a) cilësinë e përvojës profesionale në aspektin e shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të krimeve të hetuara dhe specializimeve të fituara;
 - b) aftësitë organizative, në lidhje me aftësinë e prokurorit për të organizuar në mënyrë efektive punën e tij, si edhe burimet njerëzore dhe materiale në dispozicion të tij;
 - c) aftësitë ndërpersonale, në lidhje me aftësinë e magjistratit për të pasur marrëdhënie besnike dhe efektive me eprorët, kolegët, palët, stafin administrativ, avokatët, median;
 - d) shpërndarjen e drejtë dhe të barabartë të ngarkesës së punës, ndërmjet prokurorëve në Skemë Delegimi.
3. Të dhënat e mësipërme, përftohen nga dosja personale e prokurorit në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve.
4. Në rast se ka disa kandidatë me cilësi të barabartë përvojë profesionale dhe aftësi organizative dhe ndërpersonale, do të preferohet për t'u caktuar nga Skema e Delegimit ai prokuror me përvojën më të gjerë dhe më cilësore për llojin e veprave penale, për të cilat është kërkuar caktimi dhe, në rast të barazisë së të gjithë treguesve të përmendur, do të preferohet ai me përvojën profesionale më të madhe.
5. Relacioni i përgatitur nga KZHK-ja duhet të arsyetojë gjerësisht, kriteret dhe rastet e mësipërme.
6. Këshilli e përfshin diskutimin për caktimin e prokurorit nga Skema e Delegimit, në mbledhjen plenare më të afërt. Vendimi i caktimit, përveç arsyeve të pranimit ose të kërkesës, përmban edhe arsyet e përzgjedhjes, pozicionin e caktuar ose, sipas rastit, çështjet konkrete që do të duhet të hetojë, si edhe afatin e këtij caktimi.

Neni 17

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Pas caktimit, drejtuesi i prokurorisë, raporton në Këshill, nëse nga ana e prokurorit të caktuar ka mangësi në përmbushjen e funksioneve si prokuror.
2. KZHK-ja mundet, edhe kryesisht, të monitorojë prokurorin e caktuar sipas kësaj rregulloreje.

KREU VI

STATUSI I PROKURORËVE NË PRITJE TË CAKTIMIT, TËRHEQJA NGA APLIKIMI DHE ZËVENDËSIMI I PROKURORËVE

Neni 18

Statusi i prokurorëve në pritje të caktimit

1. Prokurorët, e pranuar në Skemën e Delegimit, konsiderohen si pjesë e Këshillit, i cili vendos caktimin e tyre, sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Pas përfundimit të caktimit, prokurorët rikthehen në Këshill dhe shërbejnë në Skemë Delegimi deri në përfundimin e afatit të caktuar.

Neni 19

Tërheqja nga Skema e Delegimit

1. Një prokuror mund të tërheqë aplikimin e tij, deri në momentin që nuk është pranuar në skemë, me vendim përfundimtar nga ana e Këshillit.

2. Pas miratimit në Skemën e Delegimit, prokurori mund të kërkojë tërheqjen nga kjo skemë, për arsye serioze dhe të dokumentuara, si:

- a) probleme serioze shëndetësore që prekin prokurorin ose anëtarët e familjes;
- b) detyrime të paparashikuara personale ose familjare me ndikim të konsiderueshëm;
- c) konflikte interesi ose pengesa etike.

3. Kërkesa për revokim duhet të dorëzohet me shkrim, me dokumentacion mbështetës dhe do të shqyrtohet nga KZHK-ja, brenda 5 (pesë) ditë pune, që i paraqet propozimin e Këshillit në mbledhjen e tij më të afërt.

4. Tërheqja nga Skema e Delegimit para përfundimit të afatit të caktuar, pa plotësuar ndonjë nga shkaqet e mësipërme, bën që ky caktim të mos konsiderohet përparësi, në kuptim të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

Neni 20

Zëvendësimi i prokurorëve

1. Nëse një prokuror largohet nga Skema e Delegimit, sipas nenit 18 dhe është caktuar në një prokurori, Këshilli mund ta zëvendësojë atë me një prokuror tjetër, që është pjesë e Skemës së Delegimit.

2. KZHK-ja dhe Këshilli ndjekin, për aq sa është e mundur, rregullat dhe afatet e parashikuara në këtë rregullore.

KREU VII

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 21

Krijimi i skemës së delegimit

Këshilli, brenda datës 1 prill 2026, duhet që të krijojë Skemën e Delegimit, duke respektuar, për aq sa është e mundur, procedurat e kësaj rregulloreje.

Aneks I

FORMULAR MIRATIMI PËR PËRFSHIRJE NË SKEMËN E DELEGIMIT

Për t'u paraqitur në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në përputhje me nenin 45, të ligjit nr. 96/2016 dhe kapitullin III, të rregullores.

EMRI I PLOTË: _____

NUMRI I IDENTITETIT/KODI PERSONAL: _____

POZICIONI AKTUAL: _____

PROKURORIA KU USHTRON AKTUALISHT DETYRËN: _____

VITE PËRVOJË SI PROKUROR: _____

DEKLARATË MIRATIMI

Unë, i nënshkruari, deklaroj vullnetarisht miratimin tim për t'u përfshirë në Skemën e Delegimit të krijuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me nenin 45, të ligjit nr. 96/2016.

Konfirmoj, se plotësoj kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në ligj dhe në rregulloren nr. [•]/2025, dhe se kuptoj, sa më poshtë:

1. Mund të caktohem përkohësisht, me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në çdo prokurori brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë nivele të ndryshme të juridiksionit.

2. Caktimi im në kuadër të Skemës së Delegimit nuk përbën promovim, transferim apo masë disiplinore.

3. Pranoj të ushtroj detyrën në një caktim të tillë për një periudhë të përkohshme, sipas përcaktimit nga Këshilli, deri në një maksimum prej pesë (5) vite të akumuluar, përveç rasteve, kur ndodh një nga kushtet për tërheqjen e miratimit tim, të parashikuara në nenin 19, të rregullores nr. [•]/2025.

4. Ruaj të drejtën për t'u rikthyer në pozicionin tim të mëparshëm në përfundim të shërbimit në Skemën e Delegimit.

5. Gjithashtu, deklaroj (shënoni kutinë përkatëse):

☐ Jap miratimin për t'u caktuar në Prokurorinë e Posaçme (SPAK), nëse kërkohet dhe nëse plotësoj kushtet ligjore të parashikuara në nenin 47, të ligjit.

Vendi dhe data: _____

Nënshkrimi: _____

Aneksi II

FORMULAR KËRKESË PËR CAKTIMIN E NJË PROKURORI NË SKEMËN E DELEGIMIT

Për t'u paraqitur (nga kryetari i një Prokurorie), në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në përputhje me nenin 45(6), të ligjit nr. 96/2016 dhe kapitullin V, të rregullores.

NGA:

Emri: _____

Pozicioni: ☐ Kryetar i Prokurorisë

Institucioni: _____

Të dhënat e kontaktit (email/telefon): _____

DREJTUAR:

Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Sekretariati – Njësia e Skemës së Delegimit

KËRKESË PËR CAKTIM

Kërkoj me respekt caktimin e një magjistrati, aktualisht të përfshirë në Skemën e Delegimit, në institucionin e mëposhtëm:

Institucioni pritës: _____

Lloji i caktimit (shënoni sipas rastit):

☐ caktim për të plotësuar një pozicion vakant ose me burime të pamjaftueshme;

☐ caktim për një çështje specifike;

☐ tjetër (specifikoni): _____

ARSYETIMI I KËRKESËS

Kërkesa për caktim bëhet për shkak të kushteve të mëposhtme (shënoni të gjitha që zbatohen dhe bashkëngjitni dokumentacionin përkatës):

☐ Një ose më shumë pozicione prokuroriale janë vakante ose përkohësisht të paplota (p.sh.: leje, pezullim, dorëheqje).

☐ Institucioni po përballet me një rritje të jashtëzakonshme të ngarkesës së punës ose numrit të çështjeve.

☐ Një çështje specifike kërkon caktimin e një prokurori, që nuk ndikohet nga pengesa ligjore (p.sh. konflikt interesi, përjashtim).

☐ Ka nevojë për ekspertizë të specializuar prokuroriale që nuk është e disponueshme në ekipin aktual.

☐ Tjetër (specifikoni): _____

Informacion shtesë (përkruani çështjen/ngarkesën ose bashkëngjitni statistika):

KËRKESA SPECIFIKE (NËSE KA)

Kohëzgjatja e kërkuar e caktimit: _____

Përvojë ose aftësi të veçanta të preferuara (nëse ka):

Vendi dhe data: _____

Nënshkrimi: _____

Vula e institucionit (nëse aplikohet)